

INFRASTRUKTURA

Infrastruktura ndihmëse e fakultetit realisht është përmirësuar.

- a. Laboratori i Histori-Gjeografisë, i cili është i pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme (Kompjuterat me programe të veçanta si GIS etj., globe, harta, projektor, sistem fonije etj.)
- b. Laborator për formimin profesional të studentëve të programit 2-vjeçar "Edukim për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme" i cili është i pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme sipas specifikës së programit.
- c. Biblioteka e departamentit është pajisur me 70 tituj librash të rinj në fushën e historisë dhe gjeografisë.
- d. Zyrat e titullarëve të departamenteve janë përshtatur sipas nevojave që kanë pedagogët përkatës, duke përmirësuar kushtet e punës.

Infrastruktura e kërkimit shkencor

1. HL-4800 LABORATORI DIGJITAL I GJUHËVE TË HUAJA me kapacitet 40 vende, në dispozicion të 240 studentëve, i pajisur me projektor dhe sistem të instaluar fonije - laborator didaktik - mësimdhënie e gjuhës së huaj - përvetësim i teknologjisë së informacionit

Përdorim i pavarur dhe i thjeshtë prej Audio Masterit në mënyrat:

a) Student Demonstration/ b) Dialogue/ c) Audio Broadcasting.

Për kontrollin e të gjithë sistemeve të paracaktuara për komunikimin, ekzaminimin dhe dhënien e materialeve, kontrollin e tyre, diskutimin e studenteve dhe ndarjet në grupe.

2. E-PLUS 5: LABORATORI DIGJITAL I TRAJNIMIT TË GJUHËVE TË HUAJA , me kapacitet 20 vende- Laborator Didaktik.

- Mësimdhënie interaktive;
- Transmetim audio/video në terminale;
- Diskutime në grup (menaxhim grupi);
- Menaxhim informacioni studentësh;
- Regjistrime orale(dhe të njëkohshme);
- Sondazhe elektronike;
- Përpilim dhe zhvillimi i provimeve/detyrave online (analizë automatike rezultatesh);
- Mësimdhënie "Cloud"

3. LABORATOR DIGJITAL I FONETIKËS -Mundëson aktivitet kërkimor në fushën e fonetikës dhe proceseve të të folurit; me kapacitet 24 vende, të pajisur me projektor dhe sistem të instaluar fonije.

- Matjet të funksioneve nazale gjatë të folurit;
- Analizë sociolinguistike e të folurit;
- Analizë akustike dhe sistemim të dhënash;
- Regjistrim profesional i të foluri nga burime të ndryshme;
- Eksperiment i perceptimit të tingujve;
- Sinkronizim i tingujve të të folurit me video të regjistruar.

5. MEDiateka e Gjuhëve të Huaja të pajisur me projektor, TV, DVD dhe magnetofon.